



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 21.9.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Slavko Simiq dhe Mytaher Haskuka.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-unicef.

Pjesëmarrës të tjerë: Shpresa Zariqi-ABGJ/ZKM, Leonora Selmani-ABGJ/ZKM, Edi Gusia-ABGJ/ZKM, Habit Haradinaj-ZQM-ZKM, Fjolla Uka-KDI, Visar Bivolaku-EUO/EUSR, Bleta Gashi –Rrokum TV, Lejla Selimi-OSBE, Sead Bardhi-ZPRK-KKK, Ukë Gashi-ZPRK dhe Besmir Kokollari-Instituti ICHAT.

Mbledhjen e kryesoi Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nr.22;
3. Caktimi i përmbajtjes dhe formatit të Tryezës së rrumbullakët për barazinë gjinore në Kosovë, (të ftuar për pikë të rendit të ditës janë përfaqësuesit e Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe Agjencisë për Barazi Gjinore.);

4. Marrja e vendimit për mbikëqyrjen e zbatimit të LIGJIT Nr.03/L-183 PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE dhe formimi i grupit punues;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nr.22.;

Kryetarja e njoftoi komisionin se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 15 shtator 2015, është përgatitur por nuk është arritur të përkthehet, prandaj për shkak se nuk është i përkthyer shtyhet për miratim në mbledhjen e ardhshme.

3. Caktimi i përmbajtjes dhe formatit të Tryezës së rrumbullakët për barazinë gjinore në Kosovë, (të ftuar për pikë të rendit të ditës janë përfaqësuesit e Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe Agjencisë për Barazi Gjinore.);

Kryetarja falënderoi prezencën e të ftuarve për këtë pikë të rendit të ditës, dhe tha se së bashku do të kontribuojmë për këtë temë.

Habit Haradinaj tha se kjo ide është më se e rëndësishme dhe tani kemi filluar për të marrë nisma sidomos ajo që ka të bëjë me pakon e ligjeve, me të drejtat e njeriut, e cila si pako është aprovuar në qeveri dhe parlament, më herët kemi pasur sfida në implementimin e tyre, dhe tani është formuar një ekip që të hartojë një plan të punës me aktivitete konkrete për këto tri ligje, duke filluar me detyrat që dalin për secilin institucion për të nxjerrë aktet nënligjore, pastaj për ti vënë në funksion mekanizmat institucional në nivelin qendror dhe lokal, dhe për të punuar në aspektin e vetëdijesimit dhe edukimit gjë që përkon me këtë tryezën që planifikojmë ta organizojmë në aspektin e perspektivës gjinore.

Edi Gusia theksoi se jemi agjenci ekzekutive që ka për mandat monitorimin e zbatimit të ligjit për barazi gjinore dhe jemi në proces të planifikimit të një fushate sensibilizuese, pasi që ligji i ri ka hyr në fuqi dhe kemi menduar që kjo fushatë të organizohet në bashkëpunim me ju, dhe krejt këtë fushatë me e fillua me një tryezë diskutimi dhe do ti kishim publiku ndryshimet e reja që sjell ligji për barazi gjinore, buxhetimi gjinor është një risi në këtë ligj, që kërkon një qasje serioze. Gjatë muajit shtator e kemi pasur trajnimin e parë për buxhetimin gjinor në nivel të zyrtarëve për barazi gjinore dhe në të njëjtën kohë jemi në bashkëpunim me donatorë dhe po tentojmë që nëpërmes IKAP-së, të kemi trajnime për buxhetimin gjinor ku do të trajnoheshin zyrtarët e financave për nivelin lokal dhe nivelin qendror.

Agjencia në bazë të mandatit që ka, vazhdon me fuqizimin e ekonomisë së grave dhe tashmë është ndarë edhe raundi i ri i subvencioneve.

Valdete Bajrami pyeti se kur është parapa të mbahet kjo tryezë, që ne si komision mu koordinua bashkë me juve për të dalë sa më e frytshme kjo tryezë.

Edi Gusia -Kemi menduar që kjo tryeze të mbahet në javën e parë të tetorit, por pasi që ju keni propozuar datën 20 tetor, jemi të gatshëm që brenda atij afati kohor ta kemi një lëvizje, ne kemi parapa të mbahet në ndërtesën e qeverisë, sepse pas datës 20 tetor, jemi në bashkëpunim me OSBE-në, në trajnim nëpër komuna dhe do të kishte qenë mirë të fillohet para kësaj date.

Kryetarja - Sa i përket mbajtjes së tryezës, dakordohemi prapë , por gjithsesi do të ishte mirë të mbahet para se ju të filloni trajnimet në terren.

Habit Haradinaj- Po e diskutojmë prapë se në këtë tryezë a do të trajtohet pakoja e ligjeve për të Drejtat e Njeriut, sepse ne kemi menduar që kjo do të jetë pikë debati, ngase ne jemi fokusuar më shumë rreth kësaj pakoje.

Kryetarja theksoi se tema do të jetë e përgjithshme, perspektiva gjinore në Institucionet e Kosovës.

Valdete Bajrami- Shpresoj që ne të takohemi përsëri në mënyrë që të koordinohemi se cilat pika do të diskutohen.

Teuta Haxhiu- Më intereson të dijë se çka po bëni si agjenci për ti ndihmuar zyrat për barazi gjinore nëpër nivelet lokale, sepse nga informata që kemi janë shumë të diskriminuara, që nganjëherë kemi bindje sikur 5% me u zbatua ligji për barazi gjinore, do të ishim më të kënaqur, prandaj sa keni informata nga terreni dhe çka po ndërmerri për ti avancuar kërkesat e tyre shumë të arsyeshme që po diskriminohen në rend të parë nga nivelet lokale. Më intereson të dijë sa është numri i femrave të përfshira në policinë e Kosovës, në vendet udhëheqëse.

Edi Gusia-Agjencia për Barazi Gjinore, gjatë vitit 2015, i është drejtuar të gjitha ministrive dhe kryeministrit me një sqarim për pozicionimin e zyrtareve për barazi gjinore, ku kemi sugjerua që zyrtarët për barazi gjinore në fazën e ristrukturimit të qeverisë duhet të jenë të pozicionuara në departamentet e planifikimit strategjik, përndryshe aktiviteti i tyre do të jetë i nominizuar.

Ligji i ri për barazi gjinore na obligon në nxjerrjen e dy akteve nënligjore ku njëri prej tyre është përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të detyrave të zyrtarëve për barazi gjinore. Sa i përket institucioneve të sigurisë, për momentin nuk mund të ju ofroj shifra por do t'ua përcjellim një raport pasi që objektivi i dytë ka të bëjë me perspektivën e grave në sektorin e sigurisë.

Mexhide Mjaku-Topalli - Organizimet e tryezave janë qëllimmira, u paraqitën dy objektivat që janë parapa, objektivi i dytë ishte me interes, ndërtimi i kopshteve në institucionet e sigurisë, dhe Zyra për Qeverisje të Mirë ka filluar të hartojë një plan pas hyrjes në fuqi të këtyre tri ligjeve, ku keni arritur me këtë plan.

Disa gra për shkak të kopshteve për fëmijë që i kanë larg, nuk kanë mundësi ndoshta të punojnë, po ashtu institucionet private, posa të kuptojnë që femrat janë shtatzëna ua ndërprerjen marrëdhënien e punës, pra janë disa çështje në këtë drejtim që na brengosin të gjithëve.

Edi Gusia- Plani i veprimit në zbatim të rezolutës 1325, është një aktivitet i paraparë në këtë plan të veprimit, ndërtimi i çerdheve, kopshteve për gratë police dhe atyre të përfshira në Forcën e Sigurisë së Kosovës, pasi që në bazë të një hulumtimi është parë që gratë nga sektori i sigurisë ankohen pikërisht për shkak të mospasjes së mundësisë për ta harmonizua jetën profesionale me atë familjare dhe aty ka qenë paraparë një objektiv që këto institucione të kenë kopshte për punëtorët e veta, por nuk është realizuar ende por ka kohë që kjo të realizohet.

Salihe Mustafa- Ju përgëzoj për objektivin, për ndërtimin e kopshteve nëpër ato institucione sepse unë kam pasur takime me femrat police dhe është kërkesë e tyre dhe besoj që herën tjetër kur të takohemi, do të na njoftoni për hapat konkret që keni ndërmarrë për këtë objektiv. Më intereson të dijë, kush do të jetë i ftuar në tryezë, propozimet janë të mirëseardhura, në mënyrë tryeza të jetë sa më e kompletuar.

Kryetarja- Zonja Salihe, preku disa tema me rendësi, dhe mos të mbetet dikush që është i angazhuar dhe mund të jep kontribut në këtë fushë i paftuar, por do të kontribuojmë së bashku për këtë. Desha të pyes, cilat janë relacionet e juaja në rrafshin praktik, a janë të trajtuara mirë me ligj këto relacione dhe a mendoni që agjencia është dashur ti sjell raport drejtpërdrejt Kuvendit?

Habit Haradinaj- Zyra për Qeverisje të Mirë ka bashkëpunim të mirë me Agjencinë për Barazi Gjinore. Sa i përket çështjeve gjinore gjithçka është e qartë dhe bie në kompetencë të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe me rregulloren e zyrës së Kryeministrit, çështjet gjinore janë hequr nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe kanë kaluar te Agjencia për Barazi Gjinore që është mekanizmi kryesor.

Edi Gusia- Sa i përket çështjes së raportimit, kur kemi pasur ftesë për raportim, ne kemi qenë të gatshëm, kemi pasur një shkresë nga ana e komisionit për të bërë një raport me aktivitetet e agjencisë për vitin 2014. Atë raport e kemi dorëzuar me 10 korrik, dhe jemi gjithnjë të gatshëm të raportojmë para komisionit, por me ligjin për Barazi Gjinore agjencia nuk obligohet me raportua në Kuvend. Qeveria obligohet të raportojë çdo 4 vite për Programin për Barazi Gjinore.

Kujtim Paçaku- Ky komision ka bërë vizita në disa komuna dhe në vazhdim prapë do të ketë vizita të tilla, ku në fokus kemi zyrat për Barazi Gjinore dhe pak kemi hasur në rezultate të mira në qeveritë lokale, që mund të lavdërohen.

Më intereson të dijë se çfarë është bashkëpunimi me komunitetin pakicë në kuadër të barazisë gjinore? Kam informata se në polici pak janë respektuar punësimet e komuniteteve pakicë kur janë në pyetje femrat, dhe kam shpresë që në tryezë të marrin pjesë edhe pjesëtarët nga komunitetet.

Habit Haradinaj—Qeveria ka një strategji për integrimin e pakicave rom, ashkali dhe egjiptas, dhe çështjet gjinore kanë qenë të inkorporuara në mënyrë të përgjithshme në këtë dokument. Lidhur me këtë ai tha se kanë me pasur bashkëpunim shumë të mirë me qendrat lokale, po ashtu edhe takimet me gratë e pakicave rom, ashkali dhe egjiptas. Ekziston një projekt për komunat e Gjilanit dhe Ferizajt për dhënien e mikro grandeve për t'iu dhënë përkrahje edhe grave si dhe ekonomive të vogla.

Ai në vazhdim e specifikoi se kanë bashkëpunim të mirë edhe me Zyrën për Komunitete në kuadër të ministrisë si dhe me komunitetet e tjera siç janë ato turke, gorane, serbe, boshnjake etj.

Kryetarja kërkoi informacione rreth strategjisë së re, e cila është në përpunim e sipër.

Habit Haradinaj - Lidhur me këtë, tha se tani ata janë në fazën e parë e cila quhet faza e konsultimit dhe identifikimit të vizionit të ri. Ai e theksoi se më herët ka qenë strategjia për integrimin e tri komuniteteve kurse tani është në plan hartimi i dokumentit për të krijuar vizionin e përbashkët. Lidhur me këtë, ai tha se kanë pasur takime me qëllim të marrjes së informacioneve të mjaftuara për definimin e objektivave të strategjisë.

Në vazhdim ai e përmendi edhe pjesëmarrjen në projektin e Dekadës së Romëve, që në të kaluarën ka munguar pjesëmarrja për shkak të pengesave që kanë paraqitur Serbia dhe Sllovakia. Ai lidhur me këtë, tha se do të jenë pjesë e procesit ku edhe do të marrin obligime të caktuara që kërkohet nga shtetet e caktuara, që për këto çështje të hartojnë dokumente strategji që adresojnë çështjet. Ai tha se do të kenë obligime edhe më shumë dhe do të kenë bashkëpunim si me Komisionin për të Drejtat e Njeriut si dhe me komunitetet.

Mexhide Mjaku -Topalli – Kërkoi informacione se sa kanë pasur takime me përfaqësues të sportit të femrave që udhëhiqen nga femrat.

Edi Gusija tha se Ministria e Kulturës gjatë vitit 2014 për aktivitete të sportit femëror ka dhënë 148. 000 euro. Ndërsa për 10 klube të tjera, që janë të përziera nga meshkujt dhe femrat janë ndarë 50. 000 euro.

Mexhide Mjaku – Topalli – Kërkoi sqarime se në çfarë forme janë shpërndarë këto mjete, sepse në bazë të disa të dhënave, në disa qytete janë shpërndarë këto mjete kurse në disa qytete fare nuk janë shpërndarë.

Edi Gusia lidhur me këtë theksoi se ata i marrin të dhënat vetëm për totalin e investimeve kurse për formën e shpërndarjes nuk kanë informacione, këto informacione i posedon Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

4.Marrja e vendimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.03/L-183 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe formimi i grupit punues;

Kryetarja lidhur me këtë theksoi se është e nevojshme që të formohet grupi punues, i cili do ta bëjë monitorimin e këtij ligji, mirëpo, të gjithë anëtarët e Komisionit mund të kenë qasje në këtë proces, në mënyrë që monitorimi të jetë sa më i suksesshëm.

Mexhide Mjaku – Topalli theksoi se është e gatshme që të jetë edhe në këtë monitorim të këtij ligji.

Salihe Mustafa ishte e mendimit se monitorimi duhet të ketë një grup të ngushtë dhe çdo anëtarë që dëshiron mund ti bashkëngjitet atij grupi gjatë monitorimit të ligjit. Lidhur me këtë, ajo theksoi se gjatë monitorimit të caktuar më aktiv kanë qenë anëtarët jashtë grupit të punës sesa ata brenda grupit.

Teuta Haxhiu ishte e mendimit që të jetë komplet Komisioni dhe të jenë pjesëmarrës ata që kanë kohë më shumë. Për këtë arsye, ajo tha se është e nevojshme që lidhur me monitorimit të jetë përgjegjës i tërë Komisioni.

Salihe Mustafa theksoi se për monitorimin e ligjit për personat e verbër është punuar mjaft dhe është bërë një raport i kompletuar mjaft mirë dhe tani pritet ti përcillet Komisionit për procedim të mëtutjeshëm.

Kryetarja theksoi se Planin e Punës e ka bërë i tërë Komisioni bashkërisht dhe në realizimin e pikave nga plani qëndrojnë mirë. Nuk është ndonjë ngecje në realizimin e pikave nga Plani i Punës.

Teuta Haxhiu duke u ndërlidhur, theksoi se nuk kanë bërë punë të mirë sepse nuk janë paralel me planin e punës, qoftë për arsye objektive qoftë për ndonjë arsye tjetër, mirëpo ka akoma punë për tu bërë, me qëllim të realizimit të planit të punës. Ajo theksoi se propozimi për grup të gjerë në monitorim është më i suksesshëm sepse më shumë anëtarë mund të kryejnë punë më shumë dhe të jenë më të suksesshëm në një proces të monitorimit.

Pas debatit lidhur me këtë çështje Komisioni nxori këtë ;

V E N D I M

Komisioni vendosi që të monitorojë Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje.

5 . Të ndryshme.

Salihe Mustafa lidhur me monitorimin e ligjit për personat e verbër, kërkoi mendimin se a do të ulen si Komision për të vendosur për raportin apo si grup punues.

Kryetarja theksoi se së pari të miratohet në kuadër të grupit punues e më pas miratohet në Komision dhe procedohet për Kuvend.

Mexhide Mjaku – Topalli Lidhur me Udhëzuesin për peticione, kërkoi që të bëjnë një takim në kuadër të Komisionit me qëllim të përfundimit të punës me këtë udhëzues dhe të vazhdojnë më tutje.

Kryetarja njoftoi se nga Parlamenti Evropian kanë pranuar një ftesë për pjesëmarrje në Seminarin me temën „Roli i Avokatit të Popullit në një Demokraci moderne Parlamentare” dhe në këtë rast janë të ftuar 4 anëtarë nga Komisioni më datën 18 dhe 19 nëntor të vitit 2015 dhe pyeti anëtarët e Komisionit se cilët kush janë në gjendje që të marrin pjesë në këtë tryezë.

Në këtë seminar u vendos të marrin pjesë këta natarë:

Salihe Mustafa, Lirije Kajtazi, Kujtim Paçaku, dhe Mytaher Haskuka.

Kryetarja theksoi se gjatë vizitave të tjera ata do të bëjnë renditjen parimore se cilët anëtarë do të marrin pjesë në vizita studimore që pritet të realizohen në të ardhmen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi